

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 10-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale**  
**mbajtur më 14.03.2024**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë:** mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë nëpërmjet lidhjes video-konferencë /.**

Z. Petrushevski hapi seancën e 10-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 19:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota „pro“, miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 5-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 12.03.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 12.03.2024.
3. Propozim për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM Gostivar, me Propozim – Vendim.
4. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar nga seanca e 5-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 12.03.2024, me tekst siç ishte propozuar.

## **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 12.03.2024, me tekst siç ishte propozuar.

## **Pika 3**

z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM Gostivar. Ai shpjegoi se transmetuesi në fjalë në afatin e përcaktuar ligjor nuk e ka paguar kompensimin vjetor për lejen e transmetimit në radio. Në seancën e 8-të mbajtur më 01.03.2024, Këshilli ka inicuar procedurë për heqjen e lejes, me të cilën transmetuesit iu dhanë 15 ditë shtesë për shlyerjen e detyrimit ligjor, por edhe në afatin shtesë nuk i ka paguar mjetet. Ai informoi se para fillimit të seancës edhe njëherë është bërë kontroll në llogarinë e Agjencisë, nga ku është konstatuar se Radio PRO-FM Gostivar nuk ka kryer pagesën. Për këtë shkak, propozohet që t'i hiqet leja.

Z. Petrushevski tha se, për fat të keq, vazhdon tendenca që transmetuesit për arsye financiare çdo vit disa prej tyre të heqin dorë nga mediumi.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilën i hiqet leja për transmetim në radio, PA1 nr.08-95 datë 07.09.2023 Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, për shkak të mos pagesës së kompensimit vjetor të lejes për transmetim në radio në afatin e përcaktuar ligjor prej - 30 ditësh nga diat e pranimit të faturës me nr.2024-100-0051 datë 11.01.2024 (nr. ynë ark.0503-225/1 datë 11.01.2024).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, në ueb-faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Z.Petrushevski shprehu keqardhjen e tij për mbylljen e mediave dhe tha se shpreson në një kthesë pozitive, që transmetuesi të rifitojë lejen nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese.

## **Pika 4**

### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetar i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**